



Pranuar / Dorezuar Priljevoj/Prilato Received/Delivered	03.12.2020	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	2915/2020		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.309/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.309/2020 të datës 20.10.2020 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë rruga "Lagja Mati 1", Banerat e Tregtisë, hyrja 13, nr.40, Komuna e Prishtinës, kundër Njoftimit të datës 12.10.2020 të Ministres së Ministrisë së Financave, në çështjen juridike "mos vazhdim i kontratës së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 03.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.309/2020 e datës 20.10.2020, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr.05/39 të datës 28.09.2011, në vendin e punës "Kryeshef Ekzekutiv" në Agjencinë e Statistikave të Kosovës në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, si dhe vazhdimi të mandatit edhe për tri vite sipas Vendimit me Nr.02/198 të datës 02.10.2014 dhe Vendimit me Nr. 08/08 të datës 13.10.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës në pozitën "Kryeshef Ekzekutiv" në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Në bazë të Vendimit me Nr. 08/08 të datës 13.10.2017 mandati i ankuesit në pozitën "Kryeshef ekzekutiv" të Agjencisë së Statistikave të Kosovës ka qenë deri më datë 13.10.2020.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 28.08.2020përmes shkresë me numër protokollit 693 ka njoftuar të gjithë Sekretarët e Përgjithshëm lidhur me pozitat e kategorisë së lartë drejtuese.

Ankuesi, përmes e-mailit zyrtar më datë 21.09.2020 ka kërkuar nga zyra e Kryeministrit udhëzim dhe orientim për procesim të rizgjedhjes së Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ndërsa Udhëheqësi i Divizionit për Trupa Qeveritare-SKQ/ZKM më datë 23.09.2020 ka njoftuar ankuesin se për këtë duhet ti referohet shkresës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 26.06.2020, ndërsa më datë 05.10.2020 ankuesi i dërguar tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme dëshmitë kryesore të performancës si Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Ministrja e Ministrisë së Financave nëpërmjet e-mailit zyrtar më datë 12.10.2020 ka njoftuar ankuesin që udhëheqësi i radhës i Agjencisë së Statistikave të Kosovës duhet te emërohet sipas procedurave te rekrutimit në përputhje me Ligjin për Zyrтарët Publik.

Ankuesi, kundër njoftimit të datës 12.10.2020 të Ministres së Ministrisë së Financave , me datën 20.10.2020 ka parashtruar ankesën me numër te protokollit 2156/2020 ne Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil te Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 26.10.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës. Me datën 30.10.2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 20.10.2020 me Nr.Prot:2156/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës: Njoftimin e datës 28.08.2020 me numër protokollit Nr.693 të Ministrisë se Punëve të Brendshme, E-maili zyrtar i datës 13.10.2020 nga ankuesi, E-maili zyrtar i datës 12.10.2020 nga Ministrja e Financave dhe Transfereve, E-maili zyrtar i datës 05.10.2020 nga ankuesi, E-maili zyrtar i datës 23.09.2020 nga ankuesi, E-maili zyrtar i datës 23.09.2020, E-maili zyrtar i datës 21.09.2020 i ankuesit, Vendim i datës 31.05.2020 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 28.05.2019 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 15.05.2018 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 04.12.2017 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 15.07.2016 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 15.06.2020 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 28.05.2019 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 12.06.2018 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 30.06.2017 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 15.07.2016 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 22.12.2017 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 09.01.2013 nga Kryeministri i Kosovës, Vendim i datës 13.10.2017 nga Kryeministri i Kosovës, Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.10.2020, Përgjigja në ankesë e datës 30.10.2020 me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesi dhe organi i punësimit dhe ka konstatuar që ankesa e ankuesit Isa Krasniqi është e **pabazuar sepse:**

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se bazuar nenin 42 paragrafin 4 të Ligjit për Zyrтарët Publik dhe pikës 4 të shkresës së datës 28.08.2020 te Sekretarit te përgjithshëm te Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrja e Ministrisë së Financave ka qene e obliguar të procedoj rizgjedhjen time si Kryeshef Ekzekutiv Agjencisë së Statistikave të

Kosovës edhe për katër vite të ardhshme, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar që pretendimi ankimor i ankuesit është paqëndrueshëm sepse ankuesi Isa Krasniqi në pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës është zgjedhur më datë 28.09.2011 bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore për këtë fushë, ndërsa më datë 01.10.2014 respektivisht 13.10.2017 me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës i është vazhduar mandati tre (3) vjeçar edhe për dy here radhazi në të njëjtën pozitë deri më datë 13.10.2020, respektivisht për ankuesin nuk ka qenë mandati tij i parë ashtu siç parashihet në nenin 42 paragrafin 4 të Ligjit për Zyrtarët Publik dhe pikën 4 të shkresës së datës 28.08.2020 të Sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ka rregulluar emërimin e nëpunësve civil në pozita të kategorisë së lartë drejtues, me ç' rast ka paraparë edhe dispozita tranzitore respektivisht nenin 83 paragrafin 6, 7 dhe 8 të cilët kanë rregulluar më detajisht çështjen e pozitave të kategorisë së lartë drejtues.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke ju referuar provave të lëndës ka konstatuar që ankuesi në pozitën Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës është emëruar dhe ju ka vazhduar mandati tre (3) vjeçar dy here radhazi në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe dispozitave të nenit 22 të Rregullores Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht mandati si Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, i ka skaduar më datë 13.10.2020 sepse pozitat e nivelit të lartë drejtues kanë qene me mandat tre (3) vjeçar ashtu siç është përcaktuar me nenin 15 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës: *“Komisioni zhvillon procedurën e konkurrimit dhe në fund të saj i propozon ministrisë përgjegjëse për administratë publike tre (3) kandidaturat më të mira. Ministria përgjegjëse për administratë publike ia dërgon titullarit të institucionit për miratim (3) kandidaturat më të mira, për institucionet e ekzekutivit, Ministria përgjegjëse për administratë publike i propozon Qeverisë për miratim kandidatin e preferuar nga titullari i institucionit, i cili miratohet nga Qeveria në pozicionin përkatës për një mandat tre (3) vjeçar...”*,

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi Isa Krasniqi pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës e ka ushtruar për tri (3) mandate radhazi (nga data 28.09.2011 deri më datë 13.10.2020), çka nënkupton se mandati i tretë ankuesit i ka përfunduar më datë 13.10.2020, pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në nenin 83 paragrafin 8 ndërlidhur me neni 42 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili thekson se *„për një nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, i emëruar sipas Ligjit të Shërbimit Civil (03/L149), i cili është duke shërbyer në mandatin e tij/saj të parë, do të aplikohet neni 42..... ndërsa neni 42 paragrafi 4 parasheh se „ Emërimi në një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese, sipas paragrafit 1 të këtij neni, bëhet për një kohëzgjatje 4-vjeçare me të drejtë një rizgjatje, për të njëjtën pozitë pune, vetëm një herë dhe për të njëjtën kohëzgjatje”* dhe në rastin konkret për ankuesin Isa Krasniqi nuk ka qene mandati i tij i parë në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, andaj kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik mund t'i vazhdohet mandati, nëpunëseve civil të kategorisë së lartë drejtuese të emëruar sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të cilët e kanë ushtruar vetëm një mandat, ndërsa

nuk mund ti vazhdohet mandati nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese të emëruar sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të cilët kanë ushtruar më tepër se një mandat në te njëjtën pozite.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se ne baze nenit 83 paragrafit 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, përcaktohet se "Një nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese në një institucion të administratës shtetërore, i emëruar në këtë pozitë sipas procedurës së Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, do të vazhdojë mandatin e tij/saj për kohën e mbetur të përcaktuar në Ligjin e Shërbimit Civil nr. 03/L-149 të Republikës së Kosovës.", andaj ne rastin konkret pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, ankuesi pasi ka qenë i emëruar në pozitën e Kryeshefit ekzekutiv me mandat trevjeçar sipas procedurës së Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i njëjti e ka vazhduar mandatin e tij për kohën e mbetur respektivisht për me shume se tre muaj, deri me njoftimin e datës 12.10.2020, me te cilin Ministria e Ministrisë së Financave ne pajtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik e njofton ankuesin se udhëheqësi i radhës i Agjencisë së Statistikave do të emërohet sipas procedurave te rekrutimit me çka nënkupton se ankuesit i ka përfunduar mandati i tij.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.309/2020.

Ardita Perçuku-Shyti

Për Shqyrtim
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Malsore Gashi-Bajraktari
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit [redacted]
- Ministres se Financave ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave
- Udhëheqësit te Burimeve Njerëzore ne Agjencinë e Statistikave te Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

